

Raport

Degradimi i Shtretërve të Lumenjve

2018-2024



Prishtinë, 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministry of Environment Protection and Spatial Planning
Ministarstvo za Životnu Sredinu i Prostornog Planiranje

AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY



Raport

Degradimi i shtretërve të lumenjve 2018-2024

Prishtinë, 2026

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Qëllimi i Raportit
3. Korniza ligjore dhe institucionale
4. Metodologjia e punës
5. Identifikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit/operatoreve
6. Përshkrimi i gjendjes mjedisore të lumenjve dhe analiza e degradimit
 - 6.1. Karakteristikat e përgjithshme të lumenjve në Kosovë
 - 6.2 Përshkrimi i lumenjve kryesorë dhe karakteristikat e tyre
 - 6.3 Analiza e sipërfaqeve të degraduara
 - 6.4 Analiza krahasuese sipas lumenjve
 - 6.5 Analiza ndërvite (2008–2024)
 - 6.6 Interpretim dhe krahasim me periudhën paraprake
7. Ndikimi mjedisor dhe hidrologjik
 - 7.1. Efekti nga vërshimet/përmytjet
 - 7.2. Efektet në mjedisin ekologjik/flora dhe fauna
8. Konkluzionet dhe rekomandimet
 - 8.1. Konkluzionet
 - 8.2. Rekomandimet
9. Përfundimet

Lista e shkurtesave

MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AMMK	Agjencia për Mbrotjen e Mjedisit të Kosovës
ARPL	Autoriteti Regullator i Pellgjeve Ujore
VPRRVsë	Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet
ZRRPDV	Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve

Lista e Figurave

- Fig. 1. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Drini i Bardhë (2008–2024)
- Fig. 2. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Drini i Bardhë (2008–2024)
- Fig. 3. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Erenik (2008–2024)
- Fig. 4. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Erenik (2008–2024)
- Fig. 5. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Lumbardhi i Pejës (2008–2024)
- Fig. 6. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në Lumbardhin e Pejës (2008–2024)
- Fig. 7. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Ibër (2008–2024)
- Fig. 8. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Ibër (2008–2024)
- Fig. 9. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Morava e Binçës (2008–2024)
- Fig. 10. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Morava e Binçës (2008–2024)
- Fig. 11. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Kremenadë (2008–2024)
- Fig. 12. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Kremenadë (2008–2024)
- Fig. 13. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Desivojcë (2008–2024)
- Fig. 14. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Shipashnicë (2008–2024)
- Fig. 15. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Shipashnicë (2008–2024)
- Figure 16. Burimet, shtigjet dhe receptorët e rrezikut nga vërshimet
- Fig.17. Zonat e ekspozuara të rrezikut potencial të vërshimeve në Kosovë
- Fig.18. Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve ZRRPDV-të pellgjet lumore në Kosovë – 2020

Lista e Tabelave

- Tab. 1. Operatorët që operuan në pellgjet lumore për periudhën 2018-2025
- Tab. 2. Realizimi i inspektimeve për periudhën kohore 2018-2025
- Tab.3. Trendi i sipërfaqeve të degraduara të lumenjëve 2008–2024
- Tab. 4. Përmbledhja e VPRRVsë Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet për pellgjet lumore ndërkufitare

1. Hyrje

Republika e Kosovës disponon një sistem hidrografik të përbërë nga një rrjet i dendur dhe funksional lumenjsh, përfshirë pellgje kryesore ujore, liqene natyrore dhe akumulacione artificiale, të cilat përbëjnë një aset strategjik për zhvillimin ekonomik, sigurinë mjedisore dhe mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Ky sistem, megjithatë, karakterizohet nga një shpërndarje e pabarabartë hapësinore dhe nga një kapacitet i kufizuar natyror, duke e bërë Kosovën një vend me stres të moderuar deri në të lartë ujor në raport me kërkesat në rritje.

Menaxhimi institucional i resurseve ujore realizohet përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), respektivisht përmes Autoriteteve Rajonale të Pellgjeve Lumore (ARPL), në përputhje me kornizën ligjore dhe parimet e menaxhimit të integruar të resurseve ujore. Megjithatë, përkundër ekzistencës së kësaj kornize, evidentohet një hendek i theksuar ndërmjet dispozitave normative dhe zbatimit efektiv në terren, çka ka kontribuar në degradimin progresiv të sistemeve ujore.

Gjendja aktuale e lumenjve në Kosovë reflekton një presion të shumëfishtë antropogjen, i manifestuar përmes ndërhyrjeve fizike në shtratin dhe brigjet lumore, shkarkimit të pakontrolluar të ujërave të ndotura urbane dhe industriale, intensifikimit të proceseve erozive si dhe shfrytëzimit joracional të tokës përgjatë korridoreve lumore. Si rezultat, është cenuar integriteti ekologjik i ekosistemeve ujore, është reduktuar kapaciteti i tyre vetëripërtëritës dhe janë shtuar rreziqet e degradimit të pakthyeshëm.

Analizat sektoriale tregojnë se shumica e pellgjeve lumore në vend janë të prekura nga forma të ndryshme të degradimit, me intensitet të veçantë në Pellgun e Drinit të Bardhë, i cili përfaqëson një nga sistemet më të ndjeshme dhe më të rëndësishme hidrologjike. Në periudhën pas vitit 1999, lumenjtë janë ekspozuar ndaj një dinamike të pakontrolluar shfrytëzimi, ku aktivitetet e operatorëve ekonomikë dhe ndërhyrjet individuale kanë tejkaluar kapacitetin mbajtës të këtyre sistemeve.

Në veçanti, shfrytëzimi i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve paraqet një nga faktorët kryesorë të degradimit morfologjik dhe funksional të tyre. Edhe pse një pjesë e operatorëve janë të pajisur me pëlqime dhe leje mjedisore, praktikat reale të shfrytëzimit shpeshherë devijojnë nga kushtet e përcaktuara, duke reflektuar një deficit të theksuar në mbikëqyrje, kontroll dhe zbatim të standardeve. Në këtë kontekst, proceset e rehabilitimit të zonave të degraduara janë ose të pamjaftueshme, ose tërësisht të munguar, duke e thelluar më tej ciklin e degradimit.

Intensiteti i shfrytëzimit të inerteve në disa pjesë të lumenjve i ka tejkaluar kufijtë e rigjenerimit natyror të lumenjve, duke shkaktuar ndryshime të thella në strukturën hidromorfologjike, degradim fizik të brigjeve, humbje të habitateve ujore dhe reduktim të biodiversitetit. Ky fenomen lidhet drejtpërdrejt me kërkesën e lartë për materiale ndërtimore, si pasojë e zhvillimit të shpejtë urban dhe infrastrukturor, i cili nuk është shoqëruar me politika adekuate për menaxhim e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Në këtë kontekst, bëhet e qartë se modeli aktual i shfrytëzimit të lumenjve nuk është i qëndrueshëm dhe përbën rrezik serioz për funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale të këtyre sistemeve. Për rrjedhojë, kërkohet një rikonceptim i thellë i qasjes ndaj menaxhimit të resurseve ujore, duke kaluar nga një model reaktiv dhe fragmentar në një model proaktiv, të integruar dhe të bazuar në evidencë.

Kjo nënkupton forcimin e mekanizmave institucional, rritjen e kapaciteteve për monitorim dhe zbatim, harmonizimin e politikave sektoriale dhe integrimin e standardeve bashkëkohore për menaxhim, përfshirë edhe praktikën më të mira evropiane. Po ashtu, është e domosdoshme vendosja e një balance të qëndrueshme ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit, duke garantuar që shfrytëzimi i resurseve ujore të mos cenohet aftësinë e tyre për t'u rigjeneruar dhe për të ofruar shërbime ekosistemike në afat të gjatë.

Mbrojtja, rehabilitimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i lumenjve duhet të trajtohen si prioritet strategjik i nivelit kombëtar. Vetëm përmes një qasjeje të tillë mund të sigurohet ruajtja e këtyre resurseve si pasuri publike dhe trashëgimi natyror për gjeneratat e ardhshme, duke kontribuar njëkohësisht në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

2. Qëllimi i raportit

Degradimi i shtretërve dhe sipërfaqeve të lumenjve në Republikën e Kosovës paraqet një proces të vazhdueshëm dhe kompleks, i shkaktuar kryesisht nga mbishfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit nga operatorët legalë dhe ilegalë, si dhe nga tejkalimi i kapacitetit natyror të prurjeve dhe rigjenerimit të tyre. Ky fenomen ka shkaktuar ndryshime të thella në strukturën hidromorfologjike të lumenjve, duke ndikuar drejtpërdrejt në stabilitetin e shtretërve, funksionimin e ekosistemeve ujore dhe në shërbimet që këto sisteme ofrojnë për shoqërinë dhe ekonominë.

Raporti “Ndikimi i Shfrytëzuesve të Rërës dhe Zhavorrit në Gjendjen Mjedisore të Lumenjve” ka si qëllim kryesor vlerësimin e gjendjes mjedisore të lumenjve përmes identifikimit dhe analizës së ndryshimeve të ndodhura në shtretërit e tyre gjatë periudhës 2018–2024, duke u fokusuar në evidentimin e dinamikës së degradimit dhe intensitetit të ndërhyrjeve në kohë. Përmes këtij raporti synohet të krijohet një pasqyrë e qartë dhe e bazuar në evidencë mbi ndryshimin e gjendjes së lumenjve, duke krahasuar gjendjen fillestare me zhvillimet e mëvonshme dhe duke identifikuar zonat ku degradimi ka arritur nivele kritike.

Ky vlerësim ka për qëllim gjithashtu të evidentojë shtrirjen hapësinore të sipërfaqeve të degraduara dhe të identifikojë segmentet lumore më të prekura nga aktivitetet e shfrytëzimit të inerteve, duke analizuar ndikimin e këtyre aktivitetëve në ndryshimin e konfigurimit natyror të shtretërve, destabilizimin e brigjeve dhe prishjen e regjimit natyror të rrjedhjes. Në të njëjtën kohë, raporti trajton ndikimet negative në komponentët biologjikë dhe peizazhorë të ekosistemeve lumore, përfshirë dëmtimin e habitateve, reduktimin e biodiversitetit dhe degradimin e vlerave natyrore dhe estetike të këtyre zonave.

Një dimension i rëndësishëm i raportit është edhe vlerësimi i masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse gjatë periudhës 2018–2024, në funksion të zbatimit të legjislacionit përkatës, përfshirë ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative që rregullojnë shfrytëzimin e resurseve ujore dhe mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kuadër, raporti analizon shkallën e efektivitetit të këtyre masave në parandalimin e degradimit, në kontrollin e aktiviteteve të operatorëve dhe në përmirësimin e gjendjes mjedisore të lumenjve, duke identifikuar njëkohësisht boshllëqet dhe sfidat në zbatim.

Raporti synon po ashtu të evidentojë dëmet mjedisore të akumuluar dhe efektet kumulative të ndërhyrjeve në shtretërit e lumenjve, duke theksuar se në shumicën e rasteve intensiteti i shfrytëzimit ka tejkaluar kapacitetin natyror të lumenjve për rikuperim, çka e bën procesin e rehabilitimit tepër kompleks dhe të kushtueshëm. Në këtë kontekst, analizohen edhe faktorët që kanë ndikuar në këtë situatë, përfshirë kërkesën e lartë për materiale ndërtimore dhe mungesën e kontrollit efektiv institucional.

Raporti, bazohet në të gjeturat kryesore nga analiza e periudhës 2018–2024 dhe synon të ofrojë një bazë të qëndrueshme për hartimin e masave konkrete dhe veprimeve të domosdoshme për ndalimin e degradimit të mëtejshëm, rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe vendosjen e një qasjeje të qëndrueshme në menaxhimin e lumenjve. Në këtë mënyrë, raporti kontribuon në orientimin e politikave publike dhe vendimmarrjes institucionale drejt një modeli të integruar që garanton mbrojtjen afatgjatë të resurseve ujore dhe ruajtjen e tyre si pasuri natyrore për gjeneratat e ardhshme.

3. Korniza ligjore dhe institucionale

Kuadri ligjor dhe institucional që rregullon aktivitetin e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit, si dhe vlerësimin e gjendjes mjedisore në Republikën e Kosovës, përbën një sistem të integruar normativ që synon mbrojtjen efektive të resurseve natyrore, garantimin e përdorimit të qëndrueshëm të tyre dhe sigurimin e balancës ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së integritetit ekologjik. Ky kuadër reflekton ndërveprimin e disa ligjeve sektoriale që trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë aktivitetet e shfrytëzimit të inerteve dhe ndikimet e tyre në mjedis.

Kuadri ligjor me të cilin trajtohet dhe rregullohet aktiviteti i eksploatimit të rërës dhe zhavorrit si dhe vlerësimi i gjendjes mjedisore janë:

1. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
2. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
3. Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
4. Ligji Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale
5. Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
6. Ligji Nr. 2004/29 për Pyjet e Kosovës
7. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor
8. Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

Ky ligj përbën bazën themelore të regjimit juridik për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Kosovës dhe vendos standardet për kontrollin dhe autorizimin e aktiviteteve që kanë potencial për ndikim në mjedis. Në këtë kontekst, “leja mjedisore” përkufizohet si dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria i cili kërkohet me qëllim që të merret leja e punës.

Sipas këtij ligji, Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara.

Neni 10 i këtij ligji përcakton se asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin, i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës

Qëllimi i këtij ligji për lumenjtë e Kosovës është mbrojtja e brigjeve të ujë-rrjedhave dhe akumulimeve (Neni 48);

1. Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, të ndaluara janë veprimet :
 - 1.1. ndërrimi i drejtimit të ujit në ujë-rrjedha dhe kanale;
 - 1.2. nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujë- rrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre;
 - 1.3. ndërtimi i objekteve tjera, të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metrash nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;
 - 1.4. kryerja e punëve në afërsi të ujë -rrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre, si dhe transportimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme;
2. Ndërrimi i drejtimit, nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, ndërtimi i objekteve, kryhet vetëm nën kushtet, mënyrën dhe procedurat e caktuara sipas këtij ligji.
3. Kushtet, kriteret dhe procedurat përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Me këtë ligj rregullohet identifikimi projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimi dhe raportimi i ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis, si dhe procedurat administrative që shoqërojnë procesin e vendimmarrjes.

Ky ligj ka përcaktuar (në shtojcat e ligjit) që për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis siç janë gurthyesit, seperacionet etj., duhet të hartohet vlerësimi i ndikimit në mjedis. Kriteret për këtë ekzaminim janë dhënë në shtojcën 3.

Ligji Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale

Ky ligj rregullon hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale në Republikën e Kosovës.

Me këtë ligj resurset minerale përkufizohen si: “çfarëdo minerali metalik, industrial, ndërtimor, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, mineral energjetik ose ujë që ka vlerë potenciale ekonomike.” Me nenin 4 këtij ligji përcaktohet se ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës

Me këtë ligj rregullohen mbrojtja e natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i saj dhe veçanërisht mbrojtja, ruajtja, përtëritja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore.

Neni 5, paragrafi 1.3. përcakton parimin “shfrytëzuesi paguan” sipas të cilit shfrytëzuesi i natyrës është i detyruar të paguaj për lartësinë e shpenzimeve për mirëmbajtjen së baraspeshës natyrore dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore, si dhe të sanoj dëmtimet e natyrës që kanë ndodhur gjatë shfrytëzimit të natyrës dhe trashëgimisë natyrore.

Ligji Nr. 2004/29 për Pyjet e Kosovës

Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve.

Agjencia e Pyjeve të Kosovës është institucioni përgjegjëse për dhënien në shfrytëzim të tokave dhe pronave pyjore edhe për gurthyesit dhe rrjedhimisht kur prona është tokë pyjore, operatori nuk mund të paraqes kërkesë për pëlqim mjedisor pa kontratën për qiranë e tokës të nënshkruar nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Me këtë ligj rregullohet mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe në këmbim personave fizik dhe juridik e pronës komunale.

Ky ligj përcakton qartë se dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, qoftë afatshkurtër ose afatgjatë, duhet të bëhet përmes konkurrencës së hapur publike.

Përgjegjësit institucionale për leje të shfrytëzimit, operimit, pëlqim mjedisor, licencë për shfrytëzim dhe rivitalizim

Përgjegjësit institucionale për administrimin, menaxhimin dhe autorizimin e aktiviteteve që lidhen me shfrytëzimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës janë të organizuara përmes një sistemi të ndërlidhur të institucioneve qendrore dhe lokale, të cilat veprojnë në bazë të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin sektorial përkatës. Ky sistem përfshin një sërë procedurash administrative dhe teknike, përmes të cilave rregullohet qasja në resurset natyrore, përcaktohen kushtet e shfrytëzimit dhe vendosen obligimet për mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e zonave të ndikuara.

Procesi i autorizimit për aktivitete që lidhen me shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit është i përbërë nga disa faza të ndërlidhura, të cilat përfshijnë vlerësimin mjedisor, autorizimin ujqor, përputhshmërinë hapësinore dhe licencimin teknik të aktivitetit. Secila nga këto faza është në kompetencë të një institucioni të veçantë, duke krijuar një sistem të shpërndarë të vendimmarrjes, ku çdo institucion kontribuon në një segment specifik të procesit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është institucioni kryesor përgjegjës për lëshimin e pëlqimit mjedisor dhe lejes mjedisore, të cilat përfaqësojnë instrumentet kryesore të kontrollit paraprak të ndikimeve në mjedis. Përmes këtyre akteve, përcaktohen kushtet që duhet të plotësohen nga operatorët ekonomikë lidhur me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve, parandalimin e ndotjes dhe rehabilitimin e zonave pas përfundimit të aktivitetit. Procedura për lëshimin e këtyre lejeve përfshin analizën e dokumentacionit teknik, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe përcaktimin e masave të detyrueshme për operatorin.

Në kuadër të kompetencave të saj në sektorin e ujërave Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lëshon pëlqimin ujqor dhe lejen ujqore, të cilat janë të domosdoshme për çdo ndërhyrje në ujë-rrjedha, përfshirë nxjerrjen e inerteve nga shtretërit e lumenjve. Këto autorizime bazohen në vlerësimin e ndikimit të aktivitetit në regjimin hidrologjik, në stabilitetin e shtretërve dhe brigjeve, si dhe në funksionimin e përgjithshëm të ekosistemit ujqor. Në këtë kuadër, përcaktohen kushtet teknike dhe mjedisore që duhet të respektohen gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Komunat, si nivel i qeverisjes lokale, ka rol të rëndësishëm në aspektin e planifikimit hapësinor dhe rregullimit të përdorimit të tokës. Ajo lëshon pëlqimin për operim dhe dokumentacionin urbanistik, përmes të cilit konfirmohet nëse aktiviteti i propozuar është në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe me destinimin e zonës përkatëse. Ky dokumentacion përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit me zonimin hapësinor, infrastrukturën ekzistuese dhe kufizimet e përcaktuara për përdorimin e tokës.

Agjencia e Pyjeve të Kosovës është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore, si dhe për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve. Në rastet kur aktivitetet e shfrytëzimit të inerteve zhvillohen në zona me mbulim pyjor ose në toka të kategorizuara si pyjore, operatorët janë të obliguar të pajisen me leje përkatëse nga kjo agjenci. Kjo përfshin edhe lidhjen e kontratave për përdorimin e tokës dhe përcaktimin e kushteve për ruajtjen dhe rehabilitimin e saj.

Komisioni për Miniera dhe Minerale është institucioni përgjegjës për licencimin e aktiviteteve që lidhen me hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale, përfshirë edhe materialet inerte si rëra dhe zhavorri. Përmes licencave të lëshuara nga ky institucion, përcaktohen kushtet teknike, ekonomike dhe operacionale të aktivitetit, si dhe obligimet që lidhen me shfrytëzimin e resursit. Procesi i licencimit përfshin shqyrtimin e kapaciteteve teknike të operatorit, planit të shfrytëzimit dhe dokumentacionit mbështetës.

Në këtë kuadër institucional, secili nga institucionet ushtron kompetencat e veta në mënyrë të pavarur, por aktivitetet që lidhen me shfrytëzimin e resurseve natyrore kërkojnë një ndërveprim të vazhdueshëm ndërmjet tyre. Procesi i pajisjes me leje dhe licenca është i strukturuar në mënyrë të tillë që një autorizim shpeshherë kushtëzohet nga ekzistenca e autorizimeve tjera paraprake, duke krijuar një varësi procedurale ndërmjet institucioneve.

Ky organizim institucional reflekton një qasje sektoriale ndaj menaxhimit të resurseve natyrore, ku aspektet mjedisore, ujore, hapësinore, pyjore dhe minerare trajtohen nga institucione të ndryshme, secila në përputhje me mandatin e saj ligjor. Për rrjedhojë, procesi i autorizimit dhe menaxhimit të këtyre aktiviteteve zhvillohet përmes një sistemi të ndërlikuar procedurash, i cili kërkon koordinim dhe ndërveprim të vazhdueshëm ndërinstitucional.

Mbyllja dhe revitalizimi i vendshfrytëzimit të resurseve minerare: Pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit të resursit mineral, operatorët ekonomikë janë të obliguar që të ndërmarrin masa të plota rehabilitimi dhe rikthimi të sipërfaqes së shfrytëzuar në një gjendje sa më të afërt me atë natyrore ose në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin mjedisor dhe teknik të miratuar paraprakisht. Ky rehabilitim përfshin, ndër të tjera, rregullimin e morfologjisë së terrenit, stabilizimin e brigjeve dhe shtretërve, rikthimin e shtresës pjellore të tokës, si dhe rivendosjen e vegjetacionit përmes masave të ripyllëzimit ose rehabilitimit ekologjik. Përfundimi i këtyre aktiviteteve i nënshtrohet një procesi formal verifikimi dhe pranimit institucional, i cili realizohet nga një komision i përbashkët i përbërë nga Komisioni për Miniera dhe Minerale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës, në përputhje me kompetencat përkatëse të secilit institucion. Ky komision vlerëson përputhshmërinë e rehabilitimit me kushtet e lejeve dhe licencave të lëshuara, si dhe me standardet mjedisore dhe teknike në fuqi, dhe vetëm pas konstatimit të përmbushjes së këtyre kërkesave procedohet me pranimin zyrtar të zonës së rehabilituar.

4. Metodologjia e punës

Identifikimi dhe vlerësimi i degradimit të shtretërve lumorë paraqet një proces kompleks, i cili kërkon njohuri të thelluara profesionale dhe teknike, si dhe një qasje të strukturuar metodologjike.

Për një trajtim real dhe faktik të kesaj dukurie është e domosdoshme përcaktimi i qartë i kornizës metodologjike, definimi i objektivave kërkimore dhe përzgjedhja e indikatorëve relevantë që mundësojnë matjen dhe interpretimin e shkallës së degradimit.

Objekivi kryesor i këtij hulumtimi është vlerësimi i degradimit sipërfaqësor të shtretërve lumorë, i shkaktuar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, si rezultat i aktiviteteve të operatorëve legalë dhe ilegalë në territorin e Republikës së Kosovës. Ky vlerësim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të shtrirjes hapësinore dhe intensitetit të ndërhyrjeve në sistemet lumore.

Qasja metodologjike bazohet në një analizë shumëburimore të përfshirë e cila kombinon të dhëna nderinstitucionale, vëzhgime në terren dhe analiza të bazuara në teknologji të softwereve të GIS dhe ortofotove. Vlerësimi realizohet në nivel të pellgjeve lumore, duke mundësuar një analizë të hapësinore për periudhën kohore 2018–2024.

Në mënyrë më specifike, metodologjia përfshin:

- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore dhe pellgjeve lumore;
- Grumbullimin e të dhënave primare përmes punës në terren, duke përfshirë dokumentimin sistematik të degradimit fizik përmes evidencës fotografike;
- Përdorimin e të dhënave të ortofotove dhe imazheve satelitore për identifikimin dhe monitorimin e ndryshimeve morfologjike në shtretërit lumorë;
- Aplikimin e analizave hapësinore (GIS) për të kuantifikuar dhe vlerësuar degradimin sipërfaqësor, bazuar në interpretimin e imazheve satelitore dhe krahasimin e të dhënave për vitet 2018-2024.

Kjo qasje metodologjike mundëson një vlerësim të integruar dhe të besueshëm të degradimit të shtretërve lumorë, duke kontribuar në kuptimin më të thellë të ndikimeve antropogjene dhe duke ofruar bazë për hartimin e politikave dhe masave menaxhuese në sektorin e burimeve ujore.

5. Identifikimi i shfrytëzuesëve të rërës dhe zhavorrit/operatoreve

Bazuar në të dhënat që posedon Inspektorati i MMPH-së, si dhe në ato të ofruara nga KPMM-ja, numri i operatorëve që operojnë në shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit ndryshon nga viti në vit, shih tab.1.

Tabela 1. Operatoret që operuan në pellgjet lumore për periudhën 2018-2025

Operatoret që operojnë në pellgjet lumore	Pellgjet lumore					
	Pellgu i Drinit të Bardhë			Pellgu i Lumit Ibër	Pellgu i Lumit Lepenc	Pellgu i Lumit Morava
	Rajoni i Pejës	Rajoni i Gjakoves	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Ferizajt	Rajoni i Gjilanit
	25	23	15	8	2	7

Shumica e këtyre operatorëve eksploatojnë inertet e lumenjve (rërë dhe zhavorr), kryesisht në prona private bujqësore pranë brigjeve të lumenjve. Ndërsa, në shtratin e lumenjve janë hasur kryesisht persona fizikë, shumica prej të cilëve nuk e kanë të regjistruar aktivitetin afarist. Megjithatë, ndaj të gjithë operatorëve janë ndërmarrë masa ligjore nga Inspektorati i MMPH-së.

Në periudhën kohore 2018-2025, Inspektorati i MMPH-së ka realizuar inspektime të vazhdueshme ndaj të gjithë operatorëve, aktiviteti i të cilëve ka ndikuar në degradimin e shtretërve të lumenjve (shih tab. 2).

Tabela 2. Realizimi i inspektimeve për periudhën kohore 2018-2025

Aktivitetet e IMMPPH-së	Totali
Inspektime me procesverbal	386
Vendime për ndërprerje të punimeve	140
Vendime për ndëshkime me gjoba	206
Inicime të rasteve në gjykata	28
Përmbarim i gjobave	53
Sekuestrim i pajisjeve	mjete motorrike(Bagera,Kamiona) 62
	seperacione të rërës dhe zhavorrit 22
Persona të arrestuar	17

Shumica e aktiviteteve, veçanërisht në rastet që përbëjnë vepra penale nga operatorët ilegalë, janë trajtuar në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës – Njësitin për Hetimin e Krimeve Mjedisore, hetuesit rajonalë, si dhe me Prokuroritë Themelore në rajonet përkatëse.

6. Përshkrimi i gjendjes mjedisore të lumenjve dhe analiza e degradimit (2018–2024)

6.1. Karakteristikat e përgjithshme të lumenjve në Kosovë

Kosova karakterizohet nga një rrjet i zhvilluar hidrografik, i përbërë nga lumenj me karakteristika të ndryshme morfologjike, hidrologjike dhe ekologjike. Lumenjtë kryesorë i përkasin katër pellgjeve ujëmbledhëse: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Këta lumenj kanë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik, furnizimin me ujë, bujqësinë dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Në përgjithësi, lumenjtë në Kosovë karakterizohen nga:

- rrjedhje sezonale të ndryshueshme
- prurje të larta gjatë dimrit dhe pranverës
- ndjeshmëri e lartë ndaj ndërhyrjeve antropogjene
- kapacitet i kufizuar për vetërikuperim

Ndërhyrjet njerëzore, veçanërisht nxjerrja e rërës dhe zhavorrit, kanë ndikuar ndjeshëm në ndryshimin e morfologjisë së shtretërve të lumenjve, duke shkaktuar degradim fizik dhe ekologjik.

6.2. Përshkrimi i lumenjve kryesorë dhe karakteristikat e tyre

Drini i Bardhë

Drini i Bardhë është lumi më i madh në Kosovë dhe përbën pellgun më të rëndësishëm ujëmbledhës. Ai buron në Radavc dhe ka një rrjedhë të gjatë që përshkon pjesën perëndimore të vendit. Ky lum karakterizohet nga:

- rrjedhje e qëndrueshme me prurje të konsiderueshme
- transport i madh i materialeve aluviale (rërë dhe zhavorr)
- lugina të gjera në pjesët fushore

Për shkak të këtyre karakteristikave, Drini i Bardhë është më i ekspozuari ndaj aktivitetit të nxjerrjes së inerteve, duke e bërë atë lumin më të degraduar në vend.

Ereniku

Ereniku buron nga zonat malore të Gjeravicës dhe rrjedh drejt Drinit të Bardhë. Ai ka:

- karakter të përzier malor dhe fushor
- fuqi të madhe erozive
- kapacitet të lartë për transport sedimentesh

Ky lum është shumë i ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve, pasi ndryshimet në shtrat ndodhin shpejt dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e brigjeve.

Lumbardhi i Pejës

Ky lum buron nga Bjeshkët e Nemuna dhe ka karakter tipik malor në pjesën e sipërme dhe fushor në pjesën e poshtme. Karakterizohet nga:

- pjerrtësi e madhe në burim
- rrjedhje e shpejtë dhe erozion intensiv
- depozitimi i materialeve në pjesët e ulëta

Ndryshimet në këtë lum ndikojnë drejtpërdrejt në zonat urbane të Pejës dhe rrethinës.

Lumi Ibër

Ibri është një nga lumenjtë kryesorë në pjesën veriore të Kosovës. Ai karakterizohet nga:

- rrjedhje e rrëmbyeshme në pjesët malore
- zgjerim i shtratit në zonat urbane
- prurje të ndryshueshme sezonale

Ky lum ka filluar të përballet me rritje të presionit nga aktivitetet e nxjerrjes së zhavorrit në vitet e fundit.

Lumi Morava e Binçës

Morava e Binçës është lum me karakter të përzier, me pjesë malore dhe fushore. Karakteristikat kryesore janë:

- pjerrtësi e madhe në pjesët e sipërme
- zgjerim i shtratit në fushën e Gjilanit
- aktivitet i moderuar eroziv

Ky lum paraqet një stabilitet relativ krahasuar me lumenjtë tjerë.

Lumi Kremenadë (Krivareka)

Ky është një lum më i vogël, me:

- rrjedhje të kufizuar
- aktivitet të ulët hidrologjik
- ndikim më të vogël antropogjen

Degradimi në këtë lum është minimal.

Lumi Desivojcë

Lumi i Desivojcës ka prurje të vogla dhe karakterizohet nga:

- rrjedhje e kufizuar
- potencial i ulët për transport sedimentesh

Ky lum ka treguar shenja të rehabilitimit natyror në mungesë të aktivitetit njerëzor.

Lumi Shipashnicë

Shipashnica është një lum me rëndësi lokale, me:

- rrjedhje të vogël
- ndikim të kufizuar hidrologjik

Karakteristikë e veçantë është ndërhyrja e komunitetit lokal në rehabilitimin e zonave të degraduara.

6.3. Analiza e sipërfaqeve të degraduara (2018–2024)

Në bazë të analizave të realizuara përmes krahasimit të ortofotove dhe përdorimit të sistemeve GIS, është konstatuar se sipërfaqet e degraduara të lumenjve kanë pësuar rritje të vazhdueshme në periudhën 2018–2024.

Sipërfaqja totale e degraduar:

- **2018: 1762.71 ha**
- **2024: 2059.96 ha**

Rritja totale:

- **+297.25 ha (~16.9%)**

Kjo rritje dëshmon për vazhdim të degradimit pavarësisht përpjekjeve institucionale për kontroll.

6.4. Analiza krahasuese sipas lumenjve

Lumi Drini i Bardhë

- 2018: 1393.04 ha
- 2024: 1560.09 ha
- Ndryshimi: **+167.05 ha**

Ky lum vazhdon të ketë nivelin më të lartë të degradimit, me zgjerim të shtratit dhe dëmtim të zonave bujqësore.




Fig. 1. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Drini i Bardhë (2008–2024)

Grafiku i Drinit të Bardhë paraqet një trend të qartë dhe të qëndrueshëm në rritje të sipërfaqeve të degraduara përgjatë gjithë periudhës 2008–2024. Rritja është progresive në fazat e hershme, ndërsa pas vitit 2012 vërehet një përshpejtim i dukshëm i degradimit, duke kulmuar në vitin 2024 me vlerën më të lartë. Ky evolucion vizual e pozicionon Drinin e Bardhë si zona më e prekur, duke reflektuar presion të vazhdueshëm nga aktivitetet antropogjene dhe mungesë të kontrollit efektiv. Për shtrirjen hapësinore të sipërfaqeve të degraduara në lumin Drini i Bardhë (2008–2024), në territorin e Komunës së Prizrenit, shih fig.2.




Fig. 2. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Drini i Bardhë (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Drini i Bardhë tregon një përqendrim të theksuar të ndërhyrjeve përgjatë korridorit lumor, duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme shtratin e tij. Vërehet një zgjerim progresiv i zonave të degraduara, veçanërisht në segmentet fushore, ku ndikimi antropogjen ka favorizuar përhapjen laterale të degradimit përtej kufijve natyrorë të lumit. Intensiteti më i lartë i këtij procesi evidentohet në zonat me qasje më të lehtë dhe me aktivitet më të zhvilluar, duke reflektuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet përdorimit të territorit dhe transformimeve morfologjike të shtratit lumor. Në tërësi, modeli hapësinor i paraqitur dëshmon për një proces të vazhdueshëm dhe të pabarabartë degradimi, me tendencë zgjerimi në kohë dhe ndikim të diferencuar sipas segmenteve të lumit.

Lumi Ereniku

- 2018: 39.78 ha
- 2024: 130.67 ha
- Ndryshimi: **+90.89 ha**

Rritje shumë e shpejtë, që tregon intensifikim të aktivitetit ilegal dhe legal. Trendi i rritjes së degradimit është paraqitur në Fig.3.




Fig. 3. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Erenik (2008–2024)

Grafiku i Erenikut karakterizohet nga një rritje e moderuar në fillim, e ndjekur nga një rritje shumë e shpejtë dhe e theksuar në periudhën 2018–2024. Ky ndryshim i fortë në pjerrësinë e kurbës tregon një intensifikim të menjëhershëm të aktivitetit degradues, duke e bërë këtë lumë një nga rastet më kritike në vitet e fundit. Vizualisht, ky është një shembull tipik i një trend-i eksponencial të vonshëm. Shtrirjen hapësinore të sipërfaqeve të degraduara në lumin Erenik në territorin e Komunës së Gjakovës për vitet 2018-2024 e gjeni në fig.4.




Fig. 4. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Erenik (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Erenik paraqet një model të fragmentuar, por me intensitet në rritje në segmente të caktuara të rrjedhës. Zonat e degraduara janë të përqendruara kryesisht në kthesat e lumit dhe në pjesët me qasje më të lehtë, duke reflektuar ndikimin e drejtpërdrejtë të ndërhyrjeve antropogjene në dinamikën e shtratit lumor. Krahasuar ndër vite, vërehet një zgjerim i dukshëm i sipërfaqeve të prekura, veçanërisht në zonat fushore, ku degradimi ka marrë karakter më intensiv dhe më të shtrirë hapësinor. Ky model sugjeron një proces aktiv transformimi të morfologjisë së lumit, me tendencë për përhapje progresive dhe ndikim të diferencuar përgjatë segmenteve të tij.

Lumi Lumbardhi i Pejës

- 2018: 257.12 ha
- 2024: 291.01 ha
- Ndryshimi: **+33.89 ha**

Degradim i Lumbardhit të Pejës është i vazhdueshëm dhe gradual. Për trendin e degradimit të lumit për vitet 2018-2024, shih fig.5.




Fig. 5. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Lumbardhi i Pejës (2008–2024)

Grafiku i Lumbardhit të Pejës paraqet një rritje të vazhdueshme dhe të balancuar, pa luhate të theksuara. Ky trend linear dhe jo stabil tregon një degradim gradual, i cili është akumuluar ndër vite si rezultat i ndërhyrjeve të vazhdueshme. Forma e grafikës sugjeron një proces të qëndrueshëm presioni mbi ekosistemin lumor. Në fig.6 e gjeni shtrirjen hapësinore të sipërfaqeve të degraduara në Lumbardhin e Pejës (2008–2024).




Fig. 6. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në Lumbardhin e Pejës (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Lumbardhi i Pejës paraqet një model të vazhdueshëm linear, me përqendrim të ndërhyrjeve përgjatë gjithë rrjedhës së tij. Zonat e degraduara shtrihen kryesisht përgjatë shtratit aktiv të lumit, duke reflektuar një proces të qëndrueshëm dhe progresiv të transformimit morfologjik. Vërehet një zgjerim gradual i sipërfaqeve të prekura ndërvite, me intensitet më të lartë në segmente të caktuara ku ndërhyrjet janë më të përqendruara dhe më të vazhdueshme. Ky model sugjeron një presion të pandërprerë mbi sistemin lumor, i cili ka ndikuar në zgjerimin e shtratit dhe në ndryshimin e strukturës së tij përgjatë kohës.

Lumi Ibër

- 2018: 8.48 ha
- 2024: 23.8 ha
- Ndryshimi: **+15.32 ha**

Rritje e ndjeshme, që tregon zgjerim të aktivitetit në këtë zone, shih fig.7.




Fig. 7. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Ibër (2008–2024)

Në grafikun e Ibrit vërehet një rritje e lehtë në fazat fillestare, e ndjekur nga një rritje më e ndjeshme në periudhën e fundit. Edhe pse vlerat absolute mbeten më të ulëta krahasuar me lumenjtë kryesorë, dinamika e fundit tregon një aktivizim të ri të faktorëve degradues, duke injaluzuar nevojën për monitorim më të kujdesshëm.




Fig. 8. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Ibër (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Ibër paraqet një model të lokalizuar, me përqendrim të theksuar në segmente të caktuara të rrjedhës. Zonat e degraduara nuk janë të vazhdueshme, por të fragmentuara, duke reflektuar ndërhyrje të përkohshme dhe të përqendruara në hapësirë. Krahasimi ndërmjet periudhave tregon një zgjerim të dukshëm të sipërfaqeve të prekura, veçanërisht në segmentet ku aktivitetet antropogjene kanë qenë më intensive. Në tërësi, modeli hapësinor sugjeron një rritje të ndikimit degradues, por me shpërndarje selektive, e cila lidhet ngushtë me kushtet lokale dhe aksesin në shtratin lumor. Shtrirjen e degradimit të shtratit të Lumit në territorin e Zubin Potokut, e gjeni në fig.8.

Lumi Morava e Binçës

- 2018: 8.29 ha
- 2024: 8.29 ha
- Ndryshimi: **0 ha**

Për vitet 2018-2024, degradimi i lumit paraqet një stabilitet relativ, shih fig.9.




Fig. 9. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Morava e Binçës (2008–2024)

Grafiku i Moravës së Binçës paraqet një rritje të lehtë deri në vitin 2018, pas së cilës trendi stabilizohet plotësisht deri në vitin 2024. Ky stabilitet vizual reflekton një ndërprerje ose reduktim të aktivitetit degradues, duke e pozicionuar këtë lumë si një rast me ekuilibër të përkohshëm mjedisor.




Fig. 10. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Morava e Binçës (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Morava e Binçës paraqet një model të kufizuar dhe relativisht të qëndrueshëm, me përqendrim të ndërhyrjeve në një segment të ngushtë të rrjedhës. Zonat e degraduara janë të lokalizuara dhe nuk shfaqin zgjerim të konsiderueshëm hapësinor ndërvite, duke reflektuar një intensitet të ulët të aktivitetit degradues. Ndryshimet e vërejtura janë minimale dhe të përqendruara pranë shtratit të lumit, pa përhapje të dukshme laterale në zonat përreth. Ky model sugjeron një gjendje relative stabiliteti, ku proceset e degradimit janë të kufizuara dhe me ndikim të kontrolluar në strukturën morfologjike të lumit, shih fig.10.

Lumi Kremenadë

- 2018: 25.68 ha
- 2024: 25.94 ha
- Ndryshimi: **+0.26 ha**

Sipas trendit për 2018-2024, vërehet një ndryshim i degradimit me rritje minimale, shih fig.11.




Fig. 11. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Kremenadë (2008–2024)

Grafiku i Kremenadës karakterizohet nga një rritje minimale dhe pothuajse lineare, me ndryshime shumë të vogla ndër vite. Ky trend pothuajse horizontal tregon një nivel shumë të ulët të ndikimit degradues, duke reflektuar ose mungesë aktiviteti ose ndërhyrje sporadike dhe të kufizuara.




Fig. 12. Shtirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Kremenadë (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Kremenadë (Krivareka) paraqet një model të kufizuar dhe të fragmentuar, me përqendrim të ndërhyrjeve në segmente të veçanta të rrjedhës. Zonat e degraduara janë të lokalizuara pranë shtratit të lumit dhe nuk shfaqin zgjerim të theksuar hapësinor ndër vite, duke reflektuar një intensitet të ulët dhe sporadik të aktivitetit degradues. Ndryshimet e evidentuara janë minimale dhe pa përhapje të konsiderueshme laterale në zonat përreth. Në tërësi, modeli hapësinor sugjeron një gjendje relative stabiliteti, ku proceset e degradimit janë të kufizuara dhe me ndikim të moderuar në strukturën morfologjike të lumit, shih fig.12.

Lumi Desivojcë

- 2018: 18.91 ha
- 2024: 11.16 ha
- Ndryshimi: **-7.75 ha**

Vërehet një rënie progresive e degradimit, rehabilitim dhe ulje te aktivitetit degradues, shih fig.13.




Fig. 13. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Desivojcë (2008–2024)

Grafiku i Desivojcës paraqet një rritje fillestare deri në vitin 2012, e ndjekur nga një stabilizim dhe më pas një rënie e dukshme deri në vitin 2024. Ky model në formë “harku” tregon një proces të qartë rehabilitimi, ku reduktimi i sipërfaqeve të degraduara lidhet me ndërprerjen e aktivitetit dhe faktorë natyrorë rigjenerues.

Lumi Shipashnicë

- 2018: 11.41 ha
- 2024: 9 ha
- Ndryshimi: **-2.41 ha**

Ndikim pozitiv i ndërhyrjeve lokale. Kemi një trend të përmirësimit të gjendjes nga degradimi, shih fig.14.




Fig. 14. Trendi i sipërfaqeve të degraduara në lumin Shipashnicë (2008–2024)

Grafiku i Shipashnicës paraqet një trend në rënie të vazhdueshme në periudhën e disponueshme (2018–2024). Kjo rënie reflekton një përmirësim të gjendjes mjedisore, i lidhur me mungesën e aktivitetit degradues dhe ndërhyrjet rehabilituese nga komuniteti lokal. Vizualisht, ky përbën një nga rastet e pakta me trajektore pozitive (reduktim të degradimit).




Fig. 15. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të degraduara në lumin Shipashnicë (2008–2024)

Shpërndarja hapësinore e degradimit përgjatë lumit Shipashnica paraqet një model të fragmentuar dhe në rënie, me përqendrim të ndërhyrjeve në segmente të izoluar të rrjedhës. Zonat e degraduara janë të kufizuara dhe nuk formojnë një strukturë të vazhdueshme përgjatë shtratit të lumit, duke reflektuar një reduktim të aktivitetit degradues në kohë. Krahasimi ndërmjet periudhave tregon një zvogëlim të sipërfaqeve të prekura dhe mungesë të zgjerimit lateral, çka sugjeron ndërprerje të ndërhyrjeve dhe procese të mundshme rehabilituese. Në tërësi, modeli hapësinor dëshmon për një stabilizim gradual të gjendjes së lumit dhe një ulje të ndikimit antropogjen në këtë segment, shih fig.15.

6.5. Analiza ndër vite (2008–2024)

Sipas analizimit të të dhënave të faktuara, trendi i degradimit të sipërfaqeve të lumenjeve në Kosovë deri në vitin 2024, rezulton të jetë 2059.96 ha, shih tab.3

Tab. 3. Trendi i sipërfaqeve të degraduara të lumenjëve 2008–2024

Viti	Sipërfaqja (ha)
,	1004.77
2012	1221.07
2018	1762.71
2024	2059.96

Trend i përgjithshëm:

- rritje e vazhdueshme e degradimit
- përshpejtim i procesit pas vitit 2012

Në tërësi, të dhënat dëshmojnë se degradimi i lumenjve në Kosovë nuk është uniform, por paraqet intensitet dhe dinamikë të ndryshme sipas zonave. Ndërsa disa lumenj karakterizohen nga rritje të vazhdueshme dhe të përshpejtuara, të tjerë tregojnë stabilizim ose edhe rehabilitim, duke theksuar nevojën për qasje të diferencuar në menaxhimin mjedisor.

6.6. Interpretim dhe krahasim me periudhën paraprake

Në krahasim me vlerësimet e mëhershme:

- degradimi nuk është ndalur
- në disa lumenj është përshpejtuar
- kontrolli institucional mbetet i pamjaftueshëm

Megjithatë:

- disa lumenj tregojnë stabilizim ose rehabilitim
- ndërhyrjet lokale kanë ndikim pozitiv

7. Ndikimi mjedisor dhe hidrologjik

7.1. Efekti nga vërshimet/përmytjet

Vërshimet - Ndryshimi i tipareve gjeomorfologjike, siç janë fushat e gjera të rrethuara me male, dhe shtretërit e lumenjve të parregulluar dhe jo të mirëmbajtur, hedhja e mbeturinave në lumenj dhe nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, ndikon në shtrirjen dhe dinamikën e vërshimeve në Kosovë. Vërshimet prekin kryesisht zonat bujqësore pothuajse çdo vit duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ekologjike. Shumica e kanaleve të lumenjve nuk mund të pranojnë sasi shtesë të ujit të krijuar ngjarje ekstreme të motit, shpesh duke çuar në vërshime të një game të gjerë, shih fig.16.

"Rreziku i përmytjes" nënkupton kombinimin e probabilitetit të një ngjarjeje përmytjeje dhe të pasojave të mundshme negative për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik të lidhur me një ngjarje të vërshimeve.

Kosova është e ndjeshme ndaj vërshimeve të shpeshta. Vërshimet në nëntor 2007 prekën më shumë se 3500 familje dhe shkaktuan dëme të konsiderueshme. Që nga viti 2007, vendi është prekur gjithashtu nga vërshimet në 2010 dhe 2014. Mesatarja vjetore e popullsisë së prekur nga vërshimet në Kosovë është rreth 10,000 banorë, ndërsa mesatarja vjetore e prekur në aspektin financiar është rreth 45 milionë euro

Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet për pellgjet lumore

Nga 538 ngjarje historike të regjistruara të vërshimeve, 514 u zgjodhën për vlerësim të mëtejshëm për të përcaktuar cenueshmërinë e receptorëve të rrezikut nga vërshimet.




Figura 16. Burimet, shtigjet dhe receptorët e rrezikut nga vërshimet

VPRRV- e konsideron rrezikun e vërshimit që shfaqet nga këto shkaqe e që përfshijnë:

- burimet natyrore të vërshimeve;
- fluviale (lumenjtë, përroskat, ujërat e shpejta, shkrirja e borës);

- pluviale (ujërat sipërfaqësore), dhe
- ujërat nëntokësore;

Ngjarjet e fundit të vërshimeve të ndodhura në janar të vitit 2023, ishin pasojë e stuhive me reshje ditore deri në 134.2 mm në Klinë. Duhet të theksohet se probabiliteti i shfaqjes së reshjeve kaq të larta nuk mund të përcaktohet me besueshmëri për shkak të serive jashtëzakonisht të shkurtra e të dhënave të disponueshme.




Fig.17. Zonat e ekspozuara të rrezikut potencial të vërshimeve në Kosovë

Tërësia e zonave indikative në rrezik nga vërshimet u klasifikua në zona me rrezik të lartë, shumë të lartë dhe ekstrem, në nivel zonë kadastrale / vendbanim. Janë identifikuar 398 APSFR, nga të cilat 108 janë në rrezik ekstrem, 95 me rrezik shumë të lartë dhe 195 me rrezik të lartë. Gjithsej 398 APSFR të zonave kadastrale mbulojnë një sipërfaqe prej 3,727 km² me 326,032 banorë, 56,846 amvisëri, 24 lokacione kulturore dhe historike dhe 39 zona të mbrojtura të Kosovës.

Pellgu lumor Ibër dhe Morava e Binçes i përfshijnë 98km² sipërfaqe, të përcaktuara si në rrezik potencial domethënës të vërshimeve. Në atë zonë, 277,048 banorë, 48,793 familje, 18 objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe 21 zona të mbrojtura dhe pika të nxehta janë të ekspozuara ndaj rrezikut potencial domethënës të vërshimeve.

Pellgun lumor i Lepencit, në rrezik potencial domethënës të vërshimeve janë të ekspozuara 13 km², 38,608 banorë, 5,963 familje, 5 objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike si dhe 13 zona të mbrojtura dhe pika të nxehta.

Pellgun lumor i Drinit të Bardhë, në rrezik potencial domethënës të vërshimeve janë të ekspozuara 62 km², 27,320 banorë, 4,887 familje, 5 objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike si dhe 13 zona të mbrojtura dhe pika të nxehta. Ndërsa zona prej 79 km² është në rrezik potencial të konsiderueshëm të vërshimeve lumore, dhe 35 km² është në rrezik potencial të konsiderueshëm nga vërshimeve pluviale (rrëmbyese), shih tab.4. Ndërsa Zonat e ekspozuara të rrezikut potencial të vërshimeve në Kosovë i gjeni në fig.17.

Tabela 4. Përmbledhja e Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Vërshimet për pellgjet lumore ndërkufitare

Pellgjet lumore ndërkufitare	Pellgjet lumore në Kosovë	Numri i ZRRPDV - ve	Sipërfaqja në rrezik domethënës nga vërshimet (km ²)	Popullata në rrezik domethënës	Ekonomitë familjare në rrezik domethënës	Trashëgimia historike në rrezik domethënës	Zonat e mbrojtura në rrezik domethënës
Danub	Ibër	231	74	210,616	36,920	16	18
	Morava e Binçës	92	24	66,432	11,873	2	3
	Total	323	98	277,048	48,793	18	21
Vardari	Lepenci	51	13	38,608	5,963	5	13
	Total	51	13	38,608	5,963	5	13
Drini	Plava	12	1	4,660	852	0	2
	Drin i Bardhë	12	61	22,660	4,037	0	11
	Total	24	62	27,320	4,889	0	17

Kosova gjithashtu është në rrezik nga vërshimet në ultësira, vërshime të shpejta në zonat malore dhe prishja e digave. Rreziku nga vërshimet dhe kostoja e mundshme e dëmeve janë përkeqësuar nga kanalet lumore jo të mirëmbajtura mirë, nxjerrja e zhavorrit nga argjinaturat e vërshimit dhe ndërtimet në zonat me rrezik nga vërshimet.

Zona e modeluara mbulon 669 vendbanime nga gjithsej 1304 vendbanime në Kosovë që përbën 51%. Sipërfaqja e përgjithshme e Kosovës është 10,887 km² dhe sipërfaqja e modeluar është 5,345 km², 49% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Pjesa tjetër e Kosovës potencialisht nuk është e prekur nga vërshimet, prandaj nuk është bërë modelimi dhe hartimi i rrezikut dhe rrezikshmërisë për atë pjesë të territorit. Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve ZRRPDV-të pellgjet lumore të Kosovës e gjeni në fig.18




Fig.18. Zonat me Rrezik Potencial Domethënës të Vërshimeve të pellgjet lumore në Kosovë - 2020

Monitorimi hidrologjik dhe meteorologjik duhet të konsolidohet dhe përmirësohet më tej për të siguruar një pamje më të plotë të regjimit hidrologjik. Gjithashtu, meqenëse modelet globale të ndryshimit të klimës kanë një zgjidhje hapësinore mjaft të vogël, përpjekje të caktuara duhet të bëhen në modelimin rajonal të ndryshimit të klimës dhe / ose interpretimin për të vlerësuar më mirë pasojat e skenarëve të ardhshëm të ndryshimit të klimës në hidrologji dhe rreziqet nga vërshimet.

7.1.1. Pasojat në sektorin bujqësor

Sektori bujqësor konsiderohet ndër sektorët më të cënueshëm ndaj vërshimeve në Republikën e Kosovës. Për shkak të përqendrimit të sipërfaqeve më produktive përgjatë luginave lumore dhe ultësirave pjellore, vërshimet paraqesin një kërcënim të vazhdueshëm për prodhimtarinë bujqësore, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin ekonomik të zonave rurale.

Gjatë periudhës 2018–2025, vërshimet kanë prekur pothuajse të gjitha pellgjet kryesore lumore të Kosovës, veçanërisht ato të Drinit të Bardhë, Erenikut, Llapit, Sitnicës, Moravës së Binçës, Lepencit dhe lumenjve sekondarë. Si pasojë e reshjeve intensive dhe daljes së lumenjve nga shtretërit e tyre, janë përmytur ose dëmtuar rreth 8,000 hektarë tokë bujqësore në nivel vendi.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e prekur, vlerësohet se rreth 5,500 hektarë kanë pësuar dëmtime të drejtpërdrejta në kulturat bujqësore, ndërsa rreth 1,500 hektarë janë prekur nga sedimentimi dhe

depozitimi i materialeve inerte. Pjesa e mbetur prej rreth 1,000 hektarësh është degraduar për shkak të ndryshimit të rrjedhave lumore, gërryerjes së brigjeve dhe humbjes së shtresës pjellore të tokës.

Kulturat më të prekura rezultojnë të kenë qenë:

- drithërat (gruri, elbi dhe tërshëra)
- misri
- perimet fushore
- pemishtet
- vreshtat
- kullotat dhe livadhet
- kulturat foragjere

Në shumë raste, dëmet nuk janë kufizuar vetëm në humbjen e prodhimit të atij viti, por kanë ndikuar edhe në potencialin prodhues afatgjatë të tokës. Humbja e shtresës humusore, depozitimi i sedimenteve, gurëve dhe materialeve inerte kanë ulur ndjeshëm pjellorinë natyrore të tokës, duke kërkuar investime shtesë për rehabilitim dhe rikthim në gjendjen e mëparshme.

Përveç kulturave bujqësore, vërshimet kanë dëmtuar edhe infrastrukturën mbështetëse të sektorit bujqësor. Janë evidentuar dëmtime në sistemet e ujitjes dhe kullimit, rrugët fushore, serrat, objektet ndihmëse bujqësore, depot për ruajtjen e prodhimeve dhe pajisjet mekanike të fermerëve.

Pasojat kanë qenë veçanërisht të rënda për ekonomitë familjare rurale, të cilat varen drejtpërdrejt nga të ardhurat nga bujqësia. Në shumë raste fermerët kanë humbur të gjithë prodhimin sezonal, duke u përballur me vështirësi financiare dhe nevojë për mbështetje institucionale.

7.1.2. Ndikimi në ekonomitë familjare

Pasojat ekonomike të vërshimeve nuk kufizohen vetëm në humbjen e prodhimit bujqësor. Ato përfshijnë një gamë të gjerë dëmsh direkte dhe indirekte që ndikojnë në ekonominë lokale, zhvillimin rural dhe financat publike.

Bazuar në analizën e të dhënave të disponueshme nga komunat, institucionet përgjegjëse dhe raportet e vlerësimit të dëmeve, vlerësohet se dëmet e drejtpërdrejta në kulturat bujqësore gjatë periudhës 2018–2025 arrijnë rreth 25 milionë euro. Këto dëme përfshijnë humbjen e prodhimit, dëmtimin e kulturave shumëvjeçare dhe shpenzimet për rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura.

Kur llogariten edhe dëmet në infrastrukturën bujqësore, sistemet e kullimit, rrjetin rrugor rural, objektet ndihmëse, pajisjet bujqësore dhe humbjet indirekte ekonomike, dëmet e përgjithshme tejkalojnë 35 milionë euro.

Komunat që kanë pësuar dëmet më të mëdha gjatë periudhës së analizuar përfshijnë: Gjakovën, Pejen, Klinën, Istogun, Rahovecin, Malishevën, Drenasin, Skenderajin, Zubin Potokun, Mitrovicën, Vushtrinë, Podujevën, Gjilanin, Vitin, Kllokotin dhe Ranillukun.

Përveç dëmeve materiale, vërshimet kanë shkaktuar edhe humbje të konsiderueshme ekonomike për shkak të ndërprerjes së aktiviteteve prodhuese, pamundësisë së qasjes në parcela bujqësore, rritjes së kostove të prodhimit dhe uljes së të ardhurave të fermerëve.

Në nivel kombëtar, vërshimet ndikojnë negativisht edhe në sigurinë ushqimore, pasi reduktimi i prodhimit vendor rrit varësinë nga importet dhe ekspozon tregun ndaj luhatjeve të çmimeve. Për më tepër, kostot për rehabilitimin e infrastrukturës dhe kompensimin e dëmeve krijojnë presion shtesë mbi buxhetet komunale dhe atë qendror.

7.2. Efektet në mjedisin ekologjik/ flora dhe fauna

Studimet dhe analiza të shumta tregojnë se në vendet e Ballkanit Përendimor, gjatë dy dekadave të fundit, është evidentuar degradim i shtretërve të lumenjëve. Një vlerësim i ri dhe gjithëpërfshirës i kushteve hidromorfologjike në të gjithë Ballkanin ka zbuluar një përkeqësim të ndjeshëm të shtretërve të lumenjeve, ujërave të pastra dhe burimeve tjera natyrore.

Raporti “Gjendja hidromorfologjike e lumenjve të Ballkanit 2025”, i përgatitur nga Dr. Ulrich Schwarz i Fluvius Vienna dhe i porositur nga organizatat EuroNatur dhe Riverwatch si pjesë e fushatës “Save the Blue Heart of Europe”, analizoi 83,824 km lumenj në 11 vende.

Gjetjet e këtij raporti janë shumë shqetësuese, të cilat tregojnë se përqindja e lumenjve pothuajse natyrorë ka rënë nga 30% në vitin 2012 në 23% në vitin 2025, që përkthehet në një humbje prej 2,450 km shtretër lumenjsh, ndërsa në anën tjetër segmentet e lumenjve të modifikuar rëndë janë rritur.

Kosova si pjesë e Ballkanit Përendimor edhe pse vlerësohet se ka resurse të kufizuara ujore, ka një rrjet të pasur lumenjesh, të cilët kanë rëndësi të madhe për ekonominë e vendit, ekosistemin dhe jetën e përditshme të qytetarit.

Në anën më negative të mundshme, lumenjtë e Kosovës me dekada janë në një presion të gjithëanshem nga aktivitetet e ndryshme njerëzore. Degradimi i lumenjeve nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit që nga vitin 2000 e deri me sot janë nën presionin e vazhdueshëm nga veprimtaritë legale dhe ilegale të operatoreve ekonomik. Degradimi i lumenjve nuk prek vetëm ujin, por të gjithë ekosistemin dhe jetën e njerëzve që varen prej tij. Ruajtja e tyre është thelbësore për mjedisin, ekonominë e vendit dhe ekosistemin në përgjithësi.

Degradimi i lumenjve i cili është i shkaktuar jo vetëm nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit por edhe nga djegia dhe shpyllëzimi i florës përgjatë lumenjeve, ndërtimi i barrierave për qëllime të akumulimit të ujrave etj. Të gjitha këto forma negative të degradimit lumor, japin efekte direkte negative në ekosistemin e lumenjeve, si;

Raport Degradimi i shtretërve të lumenjve 2018-2024

- Ndryshimin e shtretëve natyral të lumenjve,
- Turbullirat me efekt ngritjen e materialeve të ngurta pezull,
- Ndryshimin e regjimeve hidrologjike dhe regjimet e ndryshuar të rrjedhës,
- Cilësia e ujit dhe eutrofikim,
- Humbja dhe fragmentimi i habitatit,
- Krijimi i humnerave dhe gropave në shtretër të lumenjeve,
- Rënia e Biodiversitetit (florës dhe faunës),
- Rritja e Erozionit dhe Sedimentimit, etj.

8. Konkluzionet dhe Rekomandimet

8.1. Konkluzionet

- Mos zbatimi i ligjeve mjedisore dhe mungesa e mbikëqyrjes paraqesin faktor nxitës të degradimit të lumenjve,
- Mbrojtja e lumenjve nuk paraqet ende një nga prioritetet kryesore dhe me përgjegjësi e institucioneve qendrore, lokale dhe sektorit të bizneseve,
- Një ndër lumenjtë me të prekur është konstatuar të jetë Lumi Drini i Bardhë, degradim i të cilit po rritet në menyrë progresive negative,
- Sipërfaqet e degraduar të lumenjeve deri në vitin 2024 është 2059.96, apo 297.25 ha më shumë krahasuar me vitin 2018,
- Disa pjesë të Lumit Drini i Bardhë janë degraduar aq shumë sa që është e vështirë kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme në kushte natyrore,
- Në nivel të përmirësimit të gjendjes degraduese është në një shkall minimale në lumenjtë; Desivojë, Shipashnicë, Kremenad dhe Morava e Binçës,

8.2. Rekomandimet

Raporti mbi gjendjen mjedisore të lumenjve, të ndikuara nga shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, paraqet të dhëna dhe analiza që dëshmojnë një degradim të theksuar dhe në rritje krahasuar me vitin 2018. Në këtë kontekst, janë hartuar rekomandime të nevojshme për zbatim nga institucionet përgjegjëse, me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe rikthimit të saj në një nivel sa më të afërt me atë të mëparshëm si vijon:

- Përmirësimi i përgjithshëm i ekosistemit dhe biodiversitetit të lumenjve përmes masave zbutëse, si: parandalimi i degradimit, rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara dhe pyllëzimi (mbjellja e drunjve).
- Angazhimi i të gjitha institucioneve përgjegjëse dhe operatorëve ekonomikë që kanë shkaktuar dëme, për hartimin dhe zbatimin e planeve të mirëfillta për përmirësimin e gjendjes mjedisore të pellgjeve lumore, me theks të veçantë në zonat e degraduara.
- Kufizimi i ndërhyrjeve në lumenj, veçanërisht atyre që lidhen me eksploatimin e rërës dhe zhavorrit, me qëllim të rivendosjes së proceseve natyrore dhe mundësimin të rikuperimit natyror të lumenjve në periudha afatshkurtra dhe afatgjata.
- Financimi i projekteve për rehabilitimin dhe rikuperimin e pjesëve të degraduara të lumenjve.
- Ndërmarrja e masave ligjore ndaj operatorëve, si ilegalë ashtu edhe legalë, që kryejnë eksploatim të rërës dhe zhavorrit në kundërshtim me kriteret dhe standardet mjedisore.
- Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i gjendjes së lumenjve nga autoritetet përgjegjëse për pellgjet ujore, si dhe ndalimi i operimit të operatorëve që shkaktojnë degradim mjedisor.
- Të përdoret teknologjia e restaurimit ekologjik të lumenjve me metoda të ndryshme për të rikuperuar popullatat biologjike dhe strukturën ekologjike të ekosistemit ujqor të dëmtuar.
- Restaurimi i lumenjve nuk rekomandohet të jet vetëm për të zgjidhur problemet e vetë lumit, por edhe për të arritur bashkëjetesën harmonike midis komunitetit të bizneseve, komunitetit lokal dhe natyrës në të gjithë pellgun lumor, zonat përreth dhe më gjerë.





9. Përfundime

Të gjeturat e raportit tregojnë se:

- Është konstatuar degradim i vazhdueshëm dhe progresiv i shtretërve të lumenjve në Republikën e Kosovës gjatë periudhës 2018–2024.
- Sipërfaqja totale e degraduar e lumenjve është rritur nga 1762.71 ha në vitin 2018 në 2059.96 ha në vitin 2024, me një rritje prej 297.25 ha apo rreth 16.9%.
- Degradimi i lumenjve është shkaktuar kryesisht nga eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit nga operatorë legalë dhe ilegalë, si dhe nga mungesa e zbatimit efektiv të legjislacionit mjedisor.
- Lumi Drini i Bardhë paraqitet si lumi më i degraduar në Kosovë, me rritje të konsiderueshme të sipërfaqeve të degraduara dhe me ndikim të theksuar në strukturën morfologjike të shtratit lumor.
- Lumi Erenik ka shënuar rritjen më të shpejtë të degradimit gjatë viteve të fundit, duke reflektuar intensifikim të aktivitetit të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit.
- Shumë operatorë ekonomikë kanë devijuar nga kushtet e përcaktuara në lejet mjedisore dhe ujore, ndërsa proceset e rehabilitimit kanë qenë të pamjaftueshme ose të pazbatuara.
- Janë evidentuar ndryshime të thella hidromorfologjike në lumenj, përfshirë zgjerimin e shtretërve, destabilizimin e brigjeve, humbjen e habitateve ujore dhe reduktimin e biodiversitetit.
- Degradimi i lumenjve ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e rrezikut nga vërshimet dhe përmytjet, sidomos në zonat me ndërhyrje intensive në shtretërit lumorë.
- Kontrolli institucional dhe mbikëqyrja nga institucionet përgjegjëse janë vlerësuar si të pamjaftueshme për të parandaluar degradimin dhe operimin ilegal.
- Disa lumenj, si Desivojca dhe Shipashnica, kanë treguar shenja rehabilitimi dhe përmirësimi të gjendjes mjedisore si rezultat i ndërprerjes së aktiviteteve degraduese dhe ndërhyrjeve lokale rehabilituese.
- Është konstatuar se modeli aktual i menaxhimit të lumenjve dhe resurseve ujore nuk është i qëndrueshëm dhe kërkon reformim institucional, forcim të monitorimit dhe zbatim më efektiv të legjislacionit.

Aneks: Imazhe fotografike nga terreni

Degradimi i Lumit Drini i Bardhë




Degradimi i Lumit Ibër




:

Degradimi i Lumit Desivojcë



Degradimi i Lumi Morava e Binçës



Raportin e përgatitën:

Tafë Veselaj-DVGJM, kryesues
Fatmir Bytyqi-DVGJM, anëtar
Ali Sefa-DMVRM, anëtar
Elbasan Shala-IM, anëtar
Sylejman Latifi-ARPL, anëtar
Rizah Murseli PH, anëtar